

**Njoftim për përqendrim me të cilin Katar Investment Autoriti, Katar dhe Audi Akciengesellschaft,
Gjermani do të fitojnë kontroll të përbashkët mbi Zauber Holding AG, Zvicër
(lënda nr. 08-163 /2024)**

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18) dhe ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" 208/24), më datë 17.12.2024 në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar Njoftim për përqendrim që i referohet fitimit të kontrollit të përbashkët nga ana e **Katar Investment Autoriti**, ("**KIA**"), me seli të regjistruar në Kullën Ooredoo (ndërtesa 14), rruga Dafna (rruga 801), rrethi Al Dafna (zona 61), Doha, kutia postare 23224, Katar, përmes shoqërisë së varur **KH** në pronësi të plotë, së bashku me **Audi Akciengesellschaft** me seli të regjistruar në Auto-Union-Shtr. 1, 85057 Ingolshat, Gjermani mbi **Zauber Holding AG** ("**Zauber**" ose "**Shoqëria e synuar**"), me seli të regjistruar në Vildbahstrase 9, 8340 Hinwil, Zvicër së bashku me dy shoqëritë e varura në pronësi të plotë të Shoqërisë së synuar, **Zauber Motorsport AG** (*Sauber Motorsport AG*) ("**ZMAG**") dhe **Zauber Tehnologhis AG** (*Sauber Technologies AG*) ("**ZTAG**") ("**Transaksioni i propozuar**"). Pas përfundimit të Transaksionit të propozuar, Audi dhe KH do të kontrollojnë bashkërisht Shoqërinë e synuar.

-Audi Akciengesellschaft është kryesisht aktive në fushën e projektimit, prodhimit, furnizimit dhe shpërndarjes së automjeteve si dhe prodhimit dhe furnizimit me pjesë rezervë për automjete. Audi është shoqëri e varur në pronësi të plotë të **Folksvagen AG**. 53.3% e aksioneve të zakonshme të **FV** janë në pronësi të **Porsche Automobil Holding SE** (*Porsche Automobil Holding SE*), që përfaqëson 31.9% të kapitalit të **FV**. Grupi **Folksvagen** është aktiv në mbarë botën kryesisht në zhvillimin, prodhimin, marketingun dhe shitjen e automjeteve për pasagjerë, automjeteve të lehta komerciale, kamionëve, autobusëve, autobusëve turistikë, shasisë për autobusë dhe motorëve dizel, motoçikletave, secili duke përfshirë pjesë rezervë për të gjitha dhe aksesorë. Grupi **Folksvagen** gjithashtu merret me shpërndarjen e automjeteve. Grupi **Folksvagen** përfshin markat e automjeteve **Folksvagen**, **Folksvagen Passenger Cars**, **Folksvagen Light Commercial**, **Porsche**, **Audi**, **Škoda**, **Bentley**, **Lamborghini**, **SEAT**, **MAN**, **Scania** dhe **Ducati**. **Folksvagen AG**, gjithashtu, kohët e fundit themeloi markën e varur **MOIA**, e cila është aktive në zhvillimin dhe marketingun e zgjidhjeve për shërbime të lëvizshmërisë, si shërbimi i transportit (ang. ride hailing) dhe ndarjes së makinave (ang. car sharing). Përveç kësaj, Grupi **Folksvagen** ofron shërbime financiare dhe të sigurimit të lidhura me shpërndarjen dhe financimin e automjeteve dhe automjeteve komerciale të tij, si dhe shërbime të drejtpërdrejta bankare. Kjo veprimtari kryesisht kryhet përmes **Folksvagen FSAG** dhe shoqërive të varura.

Grupi **Folksvagen** përfshin shoqëritë e mëposhtme të varura në Maqedoninë e Veriut:

- Shoqëria për lizing **PORSHE LIZING SHPKNJP** Shkup me **NUAS 6299482**, me seli në adresën **Bosnja dhe Hercegovina nr. 3 Shkup - Butel, Maqedonia e Veriut** dhe veprimtari prioritare - Lizing financiar;
- Shoqëria aksionare për kryerjen e punëve të ndërmjetësimit në sigurime **PORSHE BROKER AD** Shkup me **NUAS 7074158**, me seli në adresën **Bosnja dhe Hercegovina nr. 3 Shkup - Butel, Maqedonia e Veriut** dhe veprimtari prioritare - Veprimtaritë e agjentëve të sigurimeve dhe ndërmjetësuesve të sigurimeve;
- Shoqëria për shitje dhe shërbime **PORSHE MACEDONIA SHPKNJP** Shkup, me **NUAS 6025668**, me seli në adresën **Bosnja dhe Hercegovina nr. 4 Shkup - Butel, Maqedonia e Veriut** dhe veprimtari prioritare - Tregtia me automjete dhe automjete motorike të kategorisë së lehtë; dhe

- Shoqëria për tregti dhe shërbime SKANIA MACEDONIA SHPKNJP Shkup import-eksport Ilinden, me NUAS 7027532, me seli në adresën 34. nr.7 Ilinden, Shkup, Maqedonia e Veriut dhe veprimtari prioritare - Tregtia me automjete të tjera motorike.

-**KH** është një kompani globale investimesh e themeluar në vitin 2006 me seli në Doha, e themeluar dhe në pronësi të plotë të KIA. KH investon në nivel ndërkombëtar dhe lokal në kapital strategjik privat dhe publik. KIA është një fond sovran investimesh, i cili është themeluar në vitin 2005 dhe është ndër fondet më të mëdha sovraane të investimeve në nivel global. Investon në një gamë të gjerë klasash të aseteve dhe rajoneve, si dhe në partneritet me institucione udhëheqëse në mbarë botën për të ndërtuar një portofol investimesh global dhe të larmishëm me perspektivë afatgjatë që mund të sigurojë kthime të qëndrueshme. KIA gjithashtu zotëron plotësisht dhe kontrollon Katar Ervejs (Qatar Airways), i cili është sponsor global i Formula 1 deri në vitin 2027.

KIA përmes Katar Ervejs (Doha) ka një degë në Maqedoninë e Veriut-Katar Ervejs Group (K.C.S.C), shoqëri e varur e KIA, ka një degë në Maqedoninë e Veriut - **Katar Ervejs Group** (K.C.S.C) Doha Qatar - Dega Shkup, R. Maqedoni-Dega Kryesore me seli të regjistruar rr. Nikolla Kljusev nr. 6, Shkup, Maqedonia e Veriut dhe veprimtari prioritare - veprimtari shërbimi të lidhura me transportin ajror.

-**Zauber Holding AG** është një kompani e pastër holding e cila as nuk është e përfshirë në aktivitete operative dhe as drejtpërdrejt në financimin e subjekteve operative ligjore. Ajo ka dy shoqëri operative të varura: (1) ZMAG (siç është përcaktuar më lart) që mundëson angazhimin në Formula 1 të Stejk F1 Tim Kik Zauber (*Stake F1 Team Kick Sauber*), është aktiv në F1 Esports dhe zhvillon pilotë të rinj në akademinë e tij, dhe (2) ZTAG (siç është përcaktuar më lart), e cila është aktive në aktivitetet e kërkimit dhe zhvillimit të motorsportit dhe ofron ekspertizë të inductuar nga Formula 1 në inxhinieri, prodhim dhe aerodinamikë të palëve të treta. Kjo përfshin printimin 3D dhe testimin në tunel ere të produkteve dhe zgjidhjeve të ndryshme.

Bazuar në shqyrtimin paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bjerë nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtje dhe mendime për këtë përqendrim në Komision. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuara mund të dërgohen në adresën: rr. "Shën Kirili dhe Metodi" nr.54, Shkup ose me e-mail: kzk@kzk.gov.mk dhe duhet të arrijnë në Komision brenda 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

18.12.2024

Shkup